



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



# Problemet në prokurim publik: të gjeturat nga analizimi i njëmbëdhjetë tenderëve në nivel qendror dhe lokal

---

Dhjetor, 2024







# QEVERISJE E MIRË

**AUTORË:**

Ardit Dragusha &amp; Leorentë Alija



Vizitoni ueb faqen tonë  
[www.dplus.org](http://www.dplus.org)

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,  
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook  
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn  
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter  
[@democracy\\_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube  
[@Democracy.Plus](https://www.youtube.com/Democracy.Plus)

**Zyret tona:**

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V,  
Prishtinë, 10000  
Kosovë

+383 (0) 38 749 288  
[info@dplus.org](mailto:info@dplus.org)

**Deklaratë mohuese:** Ky raport është publikuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian dhe SMART Balkans. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe SMART Balkans. Projekti "Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe efiçencës në shpenzimin e parasë publike përmes prokurimit publik në Kosovë" i financuar nga BE dhe SMART Balkans, zbatohet nga Demokraci Plus (D+).

# Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave .....	6
Hyrje.....	7
Metodologjia .....	8
<b>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.....</b>	<b>9</b>
Shërbimet e transportit ajror për nevojat e MINT.....	9
Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Parkun Industrial 2 në Drenas .....	10
<b>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës .....</b>	<b>13</b>
<b>Lot 2 Ri-tender - Ndërtimi i 11 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës .....</b>	<b>13</b>
<b>Ministria e Infrastrukturës .....</b>	<b>15</b>
Trajtimi i vendeve të rrezikshme me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë rrugore (eliminimi i pikave të zeza) në rrjetin rrugor të Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse .....	15
Renovimi i objektit N.SH. Mekanizmi për vendosjen e stafit të MMPHI-së .....	16
<b>Ministria e Punëve të Brendshme.....</b>	<b>19</b>
Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare.....	19
Shërbime për dezinfektim, dezinfektim, deratizim për Ndërtesat Qeveritare - Ri tender.....	20
<b>Komuna e Gjakovës .....</b>	<b>23</b>
Ndërtimi i Rrugës X .....	23
<b>Komuna e Gjilanit.....</b>	<b>26</b>
Furnizim me uniforma për nxënës të klasave X (dhjeta) të shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit.....	26
<b>Komuna e Pejës .....</b>	<b>28</b>
Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës.....	28
Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimi nga fshati Vitomirice deri te fshati Novoselle (Rruga R106) .....	30
<b>Të gjeturat .....</b>	<b>32</b>
<b>Rekomandimet.....</b>	<b>34</b>

# Lista e shkurtesave

---

**AK** ➤ Autoritet Kontraktues

---

**AQP** ➤ Agjencia Qendrore e Prokurimit

---

**DT** ➤ Dosja e Tenderit

---

**DDD** ➤ Dezinfektim, Dezinfektim, Deratizim

---

**GEO** ➤ Grup i operatorëve ekonomik

---

**LPP** ➤ Ligji për Prokurim Publik

---

**MMPHI** ➤ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

---

**MINT** ➤ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

---

**MBPZHR** ➤ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

---

**MPB** ➤ Ministria e Punëve të Brendshme

---

**Sh.P.K** ➤ Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

---

**OE** ➤ Operator Ekonomik

# Hyrje

Demokraci Plus (D+) ka monitoruar prokurimin publik në nivel qendror dhe lokal. Qëllimi i raportit të monitorimit është të vlerësojë dhe analizojë procesin e prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal në disa autoritete kontraktuese, përfshirë: Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Komunën e Pejës, Komunën e Gjakovës dhe Komunën e Gjilanit. Ky raport përfshin një analizë të tenderëve, duke identifikuar mangësitë në proceset e prokurimit.

Këto autoritete kontraktuese, ashtu si dhe organizatat e tjera buxhetore, përdorin fondet publike për të kontraktuar operatorë ekonomikë për punë, shërbime dhe furnizime, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Kjo mënyrë siguron që shpenzimet e parasë publike të bëhen në mënyrë të drejtë, transparente dhe efikase, andaj edhe analiza dhe monitorimi i tenderëve është realizuar në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij.

Ky është raporti i dytë i monitorimit të prokurimit publik për vitin 2024, i cili përfshinë periudhën e raportimit korrik - dhjetor 2024, vazhdimësi e raportit të parë të publikuar për periudhën janar – qershor 2024<sup>1</sup>.

Në raport janë të përfshirë njëmbëdhjetë tenderë të natyrave të ndryshme, me vlerë të përgjithshme të parashikuar 8,545,218.00 euro.

Gjetjet e monitorimit tregojnë se institucionet publike iniciojnë procedurat e prokurimit pa një analizë të hollësishme të nevojave, aplikim të kriterëve diskriminuese dhe favorizuese në Dosje të Tenderëve, vazhdojnë të kontraktojnë operatorët ekonomikë që nuk i përmbushin kërkesat e vendosura në Dosje të Tenderëve si dhe bëjnë vlerësime të gabuara të cilat çojnë në vonesa dhe anulime të tenderëve.

---

<sup>1</sup> Raport i monitorimit të prokurimit publik për periudhën janar – qershor 2024, i qasshëm në [https://dplus.org/wp-content/uploads/2024/09/03-09-2024\\_Monitorimi-i-prokurimit-publik-ne-nivel-ministror-dhe-lokal.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2024/09/03-09-2024_Monitorimi-i-prokurimit-publik-ne-nivel-ministror-dhe-lokal.pdf).

# Metodologjia

Hulumtimi për realizimin e raportit të monitorimit të prokurimit publik ka filluar nga përzgjedhja, e aktiviteteve të prokurimit përmes platformës elektronike e-prokurimit dhe platformës flamujt e kuq të D+<sup>2</sup>.

Përzgjedhja është bazuar në disa indikatorë, si: vlera e parashikuar për tender, lënda që prokurohet, përsëritja e aktivitetit dhe procedura me të cilën zhvillohet aktiviteti i prokurimit, afatet kohore, çmimi i kontratës është shumë afër vlerës së parashikuar të kontratës, dhe çmimit jo normalisht të ulët.

Pas përzgjedhjes së tenderëve bazuar në indikatorët e vendosur, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ato autoritete kontraktuese të cilat janë në fokus të projektit. Kërkesat e adresuara janë bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike.

Dokumentet e siguruara janë analizuar kundrejt rregullave të prokurimit publik nëse të njëjtat janë hartuar konform rregullave të përcaktuara në legjisllacionin primar dhe sekondar<sup>3</sup>.

---

2 Flamujt e Kuq në Prokurim është platformë e cila udhëhiqet dhe mirëmbahet nga D+. Kjo platformë në mënyrë automatike tërheq aktivitetet e prokurimit nga platforma e-prokurimi të cilat potencialisht mund të kenë keqpërdorime bazuar në flamujt e kuq siç janë: afatet kohore, ofertuesi i vetëm fitues i kontratës, çmimi i kontratës është më i lartë se vlera e parashikuar apo edhe faktorë të tjerë. Për më shumë rreth platformës <https://flamujtekuq.dplus.org/>

3 Ky raport bazohet në Rregulloren e prokurimit publik 001/2022 sepse hulumtimi i tenderëve përkatës është bërë para se të ndryshohet dhe plotësohet kjo rregullore e cila ka hyrë në fuqi me 11.11.2024.



# Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

## Shërbimet e transportit ajror për nevojat e MINT<sup>4</sup>

Që nga viti 2022, lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka pësuar tre herë plotësim/ndryshime. Sipas versionit të fundit të listës, shërbimet e transportit ajror nuk bien nën domenin e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), çka do të thotë se AQP nuk udhëheq procedurat e prokurimit për të kontraktuar këtë shërbim në kuadër të kontratave të centralizuara. Mirëpo, shërbimet e transportit ajror udhëhiqen nga secili AK për nevojat e tyre të brendshme, respektivisht furnizimin me bileta të aeroplanit.

Duke qenë ky vendim në fuqi, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë (MINT) ka lidhur kontratë publike kornizë dy herë radhazi me operatorin ekonomik të njëjtë për ofrimin e këtij shërbimi, vlera e të cilave arrin shumën prej 129,003.50 euro.

**TABELA 1.** Operatori ekonomik fitues për ofrimin e shërbimeve për transportin ajror gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Nr.	Lënda e prokurimit	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar	OE fitues	Vlera e kontratës	Kohëzgjatja e kontratës
1.	Shërbimet e transportit ajror	204-23-8633-2-2-1	60,000.00€	AS Travel Club Sh.P.K	57,001.50€	12 muaj
2.	Shërbimet e transportit ajror për nevojat e MINT	204-24-5742-2-2-1	75,000.00€	AS Travel Club Sh.P.K	72,002.00€	12 muaj

Në kontratën e parë të nënshkruar gjatë vitit 2023 në mes të MINT dhe AS Travel Club Sh.P.K, respektivisht nenin 2 të saj thuhet se kjo kontratë është në fuqi për një periudhë dymbëdhjetë mujore, saktësisht deri më 21.09.2024. Megjithatë, MINT ende pa përfunduar kontrata e parë, me datën 7 qershor 2024 inicion procedurë të re “Shërbimet e transportit ajror për nevojat e MINT”, me qëllimin për të kontraktuar operatorin ekonomik për të ofruar shërbime rreth transportit ajror përmes procedurës së hapur, duke shkurtuar afatet ligjore për pranim të ofertave në kundërshtim me LPP-në.

Ky veprim sipas justifikimeve të MINT, ka ndodhur për shkak të shpenzimit të sasisë së miratuar të kontratës aktuale dhe për shkak të kërkesës së nevojshme për sigurimin e shërbimeve të vazhdueshme të transportit ajror për institucionin, respektivisht për të mbuluar nevojat e tyre operative. Kjo situatë paraqet një mospërputhje të qartë mes

<sup>4</sup> Numri i prokurimit: 204-24-5742-2-2-1.

planifikimit dhe zbatimit të kontratës, si dhe paraqet nevojë për rishikimin dhe analizën e mundësive të menaxhimit të kontratave të mëtejshme që mund të ndikojnë në integritetin e prokurimit publik të këtij autoriteti kontraktues.

Në tenderimin e dytë për kontraktimin e shërbimeve të transportit ajror, respektivisht në Dosjen e Tenderit dhe Listën Çmimeve është evidentuar mospërputhje e vlerës së përgjithshme të parashikuar për kontratë. Sipas Dosjes së Tenderit vlera e parashikuar për të kontraktuar këtë shërbim është 75,000.00 euro. Ndërkaq, sipas kalkulimeve në paramasë rezulton se vlera e saktë parashikuar e kontratës është 72,000.00 euro.

**Çmimi për njësi (360 euro) x Sasia për 12 muaj (200 njësi) = vlera totale për 12 muaj (72,000.00 euro).**

Pra, MINT ka kontraktuar operatorin ekonomik fitues AS Travel Sh.P.K me 100% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Se ky tender është karakterizuar me shkelje ligjore edhe procedurale reflektohet qartë në mënyrën se si është organizuar dhe menaxhuar procesi i tij. Një nga shkeljet kryesore është përfshirja e një anëtari të komisionit vlerësues në vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, ndërkohë që i njëjti është edhe hartues i specifikimeve teknike për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Rregullat për prokurim publik kërkojnë që proceset e prokurimit të jenë të drejta, transparente dhe objektive, dhe se ata që merren me vlerësimin e ofertave nuk duhet të kenë asnjë rol në hartimin e dokumenteve të tenderit, për të garantuar që procesi i vlerësimit të bëhet në mënyrë të paanshme. Sipas interpretimit të nenit 75 të Rregullores për Prokurim Publik nga ana e KRPP-së më datë 29 mars 2023, një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të caktohet anëtar i komisionit të vlerësimit<sup>5</sup>.

Lidhja e dy kontratave paralele nga MINT për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe konkurrencës të përcaktuara nga legjislacioni për prokurimin publik dhe me të drejtë mund të ngritën dyshime për favorizim të OE fitues. Në të dyja procedurat e prokurimit të udhëhequr nga MINT, ofertues i vetëm është operatori ekonomik fitues.

Për më tepër, ky veprim është në kundërshtim edhe me një nga parimet më të rëndësishme në prokurim publik që është ai i ekonomikitetit dhe efikasitetit. Ky parim obligon të gjitha autoritetet kontraktuese që të sigurojnë se fondet publike dhe burimet publike përdorën në mënyrë ekonomike dhe në anën tjetër paraqet një keqplanifikim të autoritetit kontraktues për të kontraktuar shërbime sipas nevojës<sup>6</sup>.

## Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Parkun Industrial 2 në Drenas<sup>7</sup>

MINT përmes procedurës së hapur dhe duke përdorur kriterin e dhënies së kontratës çmimi më i lirë ka nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik "News" SH.P.K për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për Parkun Industrial 2 në Drenas në vlerë prej 18,000.00 euro.

Sipas kriteve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, operatori ekonomik i kontraktuar do të realizon projektin ideor dhe kryesor për Parkun Industrial 2 në Drenas. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte përcaktuar 60,000.00 euro. Andaj, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara për dhënie të kontratës në këtë tender kanë ofertuar tetë operator ekonomik, ndërsa OE fitues kishte ofertuar me çmimin më të lirë.

<sup>5</sup> Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, interpretimi i datës 29.03.2023. Pyetja 23, 29.03.2023, e qasshme në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=544>

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 6.

<sup>7</sup> Numri i prokurimit: 204-23-8829-2-2-1.

**TABELA 2.** Operatorët ekonomik ofertues dhe vlera e ofertave

Nr.	Operatori ekonomik	Vlera e ofertave
1.	GEO Enggroup Sh.P.K & Armiring Sh.P.K & Alping Sh.P.K	58,460.00 €
<b>2.</b>	<b>News Sh.P.K</b>	<b>18,000.00 €</b>
3.	Proing&Partners Sh.P.K	54,000.00 €
4.	N.N.SH. Vizion Project	33,400.00 €
5.	Studio Hapsira Sh.P.K	36,889.00 €
6.	GEO Rimi Eng Sh.P.K & 3D Project & N.T.Sh Studio Zero	35,000.00 €
7.	Instituti i Shkences dhe i Teknologjise Insi Sh.P.K	54,219.00 €
8.	GEO Vizioni B Sh.P.K & Hidro-Project Sh.P.K & Eni Desing Sh.P.K	33,400.00 €

Sipas ofertave të kompanive ofertuese të paraqitura në tabelën më lartë, vërehet se ka dallime në çmime nga ana e ofertuesve, ndërkaq oferta e OE fituese është 70% më e ulët se sa vlera e parashikuar e kontratës. Në këtë kuptim, anëtarët e komisionit vlerësues gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave do të duhej të konsideronin rregullat për tenderë me çmime jo-normalisht të ulëta duke respektuar në përpikëri legjislacionin në fuqi për prokurim publik dhe të njëjtat të pasqyroshin në raportin e vlerësimit.

Rregullat për prokurim publik përcaktojnë qartë kushtet për tu konsideruar një tender jo-normalisht i ulët<sup>8</sup>. Në rastin konkret, janë dorëzuar tetë oferta me çmime të ndryshme. Çmimi më i ulët i ofruar është 18,000.00 euro dhe duke marrë parasysh ofertat e tjera, kjo ofertë është shumë më e ulët se sa çmimi mesatar. Sipas kalkulimeve, çmimi mesatar i ofertave është 40,421.00 euro, ndërsa oferta më e ulët është rreth 55% më e ulët se çmimi mesatar. Tjetër, çmimi i ofertës më të ulët (18,000 euro) është 46% më i ulët se çmimi i ofertës së dytë më të ulët të ofertave (33,400 euro), i cili është kushti i fundit i plotësuar për të cilin mund të konsiderohet dhe cilësohet oferta e operatorit ekonomik si jo-normalisht e ulët.

<sup>8</sup> Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 41.3.

GEO Rimi Eng Sh.P.K & 3D Project & N.T.Sh Studio Zero që kishte ofertuar në këtë tender paraqitën kërkesë për rishqyrtim pranë MINT, me pretendimin se nuk është respektuar barazia e operatorëve ekonomik, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, kriteret e dhënies së kontratës, dhe rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët. Sipas rregullave për prokurim, kërkesa për rishqyrtim duhet të trajtohet brenda një periudhe prej pesë ditësh, megjithatë MINT vendimin për refuzim të kërkesës si të palejuar mbi pretendimet e palës ankuese e merr pas tejkalimit të afatëve ligjore për shqyrtimin e saj duke konsideruar se ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderëve është në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe se operatori ekonomik fitues i plotëson kriteret e përcaktuara në njoftim për Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontratë<sup>9</sup>.

Sipas raporteve të pagesave të analizuara, pagesat për këtë kontratë janë realizuar në tërësi, ndërsa kontrata për “Ndërtimin e Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 – Parku i Përgjithshëm në Drenas“, tashmë është nënshkruar.

---

9 Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 60.1, pika b.

# Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

## Lot 2 Ri-tender - Ndërtimi i 11 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës<sup>10</sup>

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) me 15 gusht 2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive në pjesën veriore të Kosovës të ndarë në dy lote: Lot 2 Ri-tender - Ndërtimi i 11 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës dhe Lot 3 - Ri-tender Renovimi i 4 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës me vlerë të parashikuar 853,000.00 euro. Ndërkaq, aprovimi i kërkesës së MMPHI nga Qeveria e Republikës së Kosovës për realizimin e projektit është dhënë një muaj pas inicimit të procedurës së tenderimit<sup>11</sup>.

Në bazë të analizimit të Dosjes së Tenderit, MMPHI për këtë tender të llojit punë në Aneksin 1 të DT-së nuk ka përcaktuar specifikimet teknike të detyrueshme dhe kjo është bërë vetëm përmes Listës së Çmimeve, e cila nuk ka një specifikim të detajuar për secilin produkt ashtu siç kërkohet sipas nenit 28 të LPP-së<sup>12</sup>. Gjersa si bartës i kësaj procedure të prokurimit autoriteti kontraktues shkurttoi edhe afatin për dorëzimin e tenderëve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në 15 ditë nga 40 ditë sa është e paraparë për kontratat e punës me vlerë të madhe.

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, autoriteti kontraktues me datë 12 shtator 2023 publikoi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke rekomanduar për kontratë për Lot 2 ofertuesin e vetëm LimitProject Sh.P.K & RoArchitecture Sh.P.K dhe Rinesa Sh,P,K me vlerë të kontratës 649,432.66 euro apo 99.91% e vlerës së parashikuar të kontratës.

**TABELA 3.** Operatori ekonomik ofertuese në këtë tender dhe vlera e ofertës

Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës për LOT II
1.	GEO LimitProject Sh.P.K & RoArchitecture Sh.P.K dhe Rinesa Sh,P,K	649,432.66 euro

Për Lot 2, MMPHI më 21 shtator 2023 nënshkruan kontratë me konsorciumin e përbërë nga LimitProject Sh.P.K & RoArchitecture Sh.P.K dhe Rinesa Sh,P,K në kohëzgjatje 12 muajore e cila përcakton specifika të qarta lidhur me punët dhe afatet e sakta për përbushjen e kontratës. Megjithatë, ende pa u përbushur kushtet e kontratës bazë, nënshkruhet aneks-kontratë për realizimin në tërësi të projektit, të cilat pas analizimit të listës së çmimeve kryesisht ndërlidhen me punët fillestare të kryerjes së punimeve siç janë: punimet përgatitore, punët e demolimit, pastrimit, muratimit dhe betonimit<sup>13</sup>. Sipas rregullave të prokurimit publik, një kontratë për punë shtesë mund të

<sup>10</sup> Numri i prokurimit: 210-23-8588-5-1-1.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 162/2023 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, dt. 27.09.2023.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 28.

<sup>13</sup> Aktiviteti i prokurimit me numër 210-24-4524-5-2-5.

nënshkruhet në rastet kur punët nuk janë përfshirë, dhe as kryer në kontratën origjinale, por të cilat për arsye të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.

Për më tepër, katër muaj pas aneks-kontratës është zhvilluar edhe një procedurë e re e prokurimit për të njëjtën çështje, duke përdorur kriteret e njëjta për dhënien e kontratës sikurse në tenderin e parë.

**TABELA 4.** Kontratat e GEO LimitProject Sh.P.K & RoArchitecture Sh.P.K dhe Rinesa Sh.P.K për ndërtimin e shtëpive në pjesën veriore

Nr.	Titulli i kontratës	Vlera e kontratës	Kohëzgjatja e kontratës
1.	Ri-tender Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive në pjesën veriore të Kosovës	649,432.66 euro	12 muaj
2.	Punë shtesë- LOT 2 Ri-tender Ndërtimi i 11 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës	63,725.72 euro	60 ditë
3.	Punë të pa parapara për projektin Ri-tender Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive në pjesën veriore të Kosovës Lot 2	128,007.54 euro	182 ditë

Mungesa e një analize të hollësishme të nevojave ka bërë që ndarja e fondeve të bazohet vetëm në një pasqyrë të përgjithshme, pa adresuar plotësisht kërkesat dhe prioritetet specifike për realizimin e projektit. Sipas Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve, vlera e zotuar për këtë projekt është 650,000.00 euro. MMPHI si autoritet kontraktuese ka nënshkruar tri kontrata paralele për realizimin e projektit në tërësi me të njëjtin operator ekonomik në vlerë totale prej 841,165.92 euro.

# Ministria e Infrastrukturës

## Trajtimi i vendeve të rrezikshme me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë rrugore (eliminimi i pikave të zeza) në rrjetin rrugor të Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse<sup>14</sup>

Ministria e Infrastrukturës (MI) me 26 prill 2024 hapi tenderin për trajtimin e vendeve me rrezikshmëri të lartë në infrastrukturës rrugore (pikave të zeza), pra segmenteve rrugore të cilat kanë numrin më të lartë të aksidenteve me fatalitet, lëndime të rënda dhe aksidente të shpeshta. Objektivi kryesor i këtij projekti, në vlerë të parashikuar të kontratës 1,500,000.00 euro, është eliminimi i këtyre pikave të zeza duke ndërhyrë në përmirësimin e gjeometrisë, sinjalizimit vertikal dhe horizontal dhe ndriçimit.

Me datën 10 qershor 2024, MI publikoi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, duke rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomikë “TSR Sh.P.K., & IDK Konstruksion Sh.P.K.”, ndaj të cilit paraqitën ankesa dy operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, “El Bau” dhe “Intrast Sh.P.K”. MI hodhi poshtë këto kërkesa, duke vlerësuar se pretendimet ankimore ishin të pabazuara. Dy vendimet e MI-së, për refuzim të kërkesave për rishqyrtim shkelin nenin 108/A të LPP, i cili thekson se refuzimi për rishqyrtim duhet të jetë i arsyetuar. Në këtë rast, MI i përfshiu të gjitha pretendimet e operatorëve ekonomikë në një vend, duke i refuzuar në tërësi me një arsyetim të përgjithësuar, pa ofruar argumente për pretendimet e ngritura. Autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të ju përgjigjen secilit operator ekonomik me vendim për secilin pretendim ankimor, duke dhënë përgjigje me shkrim në përputhje me ligjin për parashtuesit e ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

Pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim, operatorët ekonomikë parashtuan ankesa në OShP, e cila anuloi vendimin për dhënie të kontratës<sup>15</sup>, duke kthyer lëndën në rivlerësim pasi komisioni i vlerësimit të MI kishte:

- Rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili nuk kishte nënshkruar planin për menaxhim të trafikut, që kishte qenë kërkesë në Dosje të Tenderit;
- Rekomanduar për kontratë pa kërkuar sqarime operatorin ekonomik i cili kishte ofruar çmime jo normalisht të ulëta në disa pozicione (4.17, 4.18, 4.20), në raport me çmimet e tregut, si dhe kishte ofruar çmime jo normalisht të larta në disa pozicione (2.1, 2.2, 2.5, 3.1, 3.2, 3.6, 3.10, 3.11 dhe 5.1).

Ndonëse LPP dhe legjislacioni sekondar ndalojnë përjashtimin automatik<sup>16</sup> të ofertave jo-normalisht të ulëta, MI është dashur të përdor procedurën inter-partes me operatorin ekonomik duke kërkuar shpjegime për çmimet e ofruara.

Pas anulimit për dhënie të kontratës, MI publikoi vendimin me anë të të cilit bëri anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi komisioni i rivlerësimit erdhi në përfundim se të gjitha ofertat kishin qenë të papërgjegjshme. MI, në Dosjen e Tenderit kishte kërkuar inxhinier të diplomuar të elektronikës me tri (3) vite përvojë pune profesionale pas diplo-

<sup>14</sup> Numri i prokurimit: 205-24-4174-5-1-1.

<sup>15</sup> Vendimi i OShP me nr. 2024/0587.

<sup>16</sup> Rregullorja nr. 01/2022 e Prokurimit Publik. Neni 41.

mimit, i cili duhej dëshmuar me CV, diplomë të noterizuar, kontratë të punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), dhe referenca për punët e mëparshme. Operatori ekonomik i eliminuar për këtë pikë të DT, “El Bau Sh.P.K”, kishte prezantuar një kontratë të punës me inxhinierin e elektroteknikës V.J, kontratë e cila kishte skaduar me 31 dhjetor 2023.

Në përputhje me LPP-në<sup>17</sup>, autoritetet kontraktues kanë mundësinë të kërkojnë plotësimin ose sqarimin e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me parimet e barazisë dhe transparencës. Kjo përfshinë situatën kur dokumentet e paraqitura janë të pasakta, ose të paplota, duke ju mundësuar operatorëve ekonomikë që të ofrojnë informacion shtesë për të plotësuar kërkesat e tenderit. Në rastin konkret, operatori ekonomik i eliminuar ka paraqitur kontratë të mëparshme të skaduar për inxhinier, por në ankesë ai ka ofruar një kontratë të re dhe valide, e cila ishte nënshkruar dhe noterizuar<sup>18</sup> para hapjes së tenderit. Kjo kontratë e noterizuar që është paraqitur nga operatori ekonomik ankues, e lidhur pas datës së skadimit të kontratës së mëparshme por para inicimit të tenderit, përmbush kërkesat e LPP-së, specifikisht nenit 72, i cili mundëson sqarimin e dokumentacionit. Dokumentacioni i ofruar nga operatori ekonomik ankues për këtë kërkesë të MI-së, përfshinë kontratën e noterizuar dhe dëshminë e listës së pagave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), vërteton ekzistimin e mardhënies së punës në mënyrë objektive para hapjes së tenderit. Pra, MI ka mundur dhe është dashur të kërkojë dhe pranojë sqarime shtesë për të konfirmuar plotësimin e kushteve të vendosura në Dosje të Tenderit.

Një tjetër element i Dosjes së Tenderit, i cili u vlerësua nga MI se nuk ishte plotësuar, ishte kërkesa për listën e kontratave/projekteve të përfunduara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rikonstruktimit të rrugëve dhe sinjalizimit, për periudhën tri (3) vjeçare, projekte të cilat duhet të ishin jo më pak se 2,000.000 euro. Pavarësisht se operatori ekonomik “El Bau Sh.P.K”, dorëzoi listën dhe dëshmitë për projekte të realizuara në vlerë 6,763,551.56 euro, MI refuzoi ofertën e tij, duke argumentuar se nuk plotëson kërkesat dhe se vlera totale për në lëminë e asfaltimit, ndërtimit dhe rikonstruktimit nuk tejkalon shumën 1,685,223.95 euro. Nga analizimi i ofertës së dorëzuar, ky operator ekonomik ofroi procesverbal për pranimin përfundimtar të punëve dhe referenca për kontrata të realizuara në lëmitë e kërkuara në vlerë 2,094,585.81, që përmbush kërkesën e autoritetit kontraktues.

## Renovimi i objektit N.SH. Mekanizmi për vendosjen e stafit të MMPHI-së<sup>19</sup>

Ministria e Infrastrukturës në shtator të vitit 2024, publikoi Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë „Renovimi i objektit N.SH. Mekanizmi për vendosjen e stafit të MMPHI-së“. Ky aktivitet i prokurimit i cili nuk ishte i përfshirë në planin përfundimtar të prokurimit kishte vlerë të parashikuar prej 900,000.00 euro me kohëzgjatje të kontratës për 60 ditë nga momenti i nënshkrimit të saj.

Në këtë aktivitet të prokurimit të zhvilluar sipas procedurës së hapur mori pjesë vetëm një ofertues, i cili rezultoi edhe si fitues i kontratës. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak të shkurtimit të afateve ligjore për ofertim nga ana e AK-së pa ndonjë arsyetim i cili ka ndikuar në përgatitjen e ofertave nga ana e OE-ve të interesuar për 13 ditë. Për tender me vlerë të madhe<sup>20</sup>, afati për të dorëzuar ofertat është 40 ditë dhe në rastet kur aplikohen rregullat e posaçme për shkurtim të afateve, koha është 15 ditë<sup>21</sup>.

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L- 042 për Prokurimin Publik, Neni 72.

18 Akti noterial LRP. Nr.1105/2024, i datës 01.02.2024.

19 Numri i prokurimit: 205-24-10028-5-1-1.

20 Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurim Publik, Klasifikimi i kontratave publike sipas vlerës, i qasshëm në [https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A02\\_Udhezues%20Nr-001\\_2023%20per%20prokurimin%20publik.pdf](https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A02_Udhezues%20Nr-001_2023%20per%20prokurimin%20publik.pdf)

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L- 042 për Prokurimin Publik, neni 46.2.



**TABELA 5. Operatori ekonomik i vetëm ofertues dhe fitues në këtë procedurë të prokurimit**

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës
1.	GEO Krapo Com Shp.K & Home Electronics	876,829.89€

Një faktor tjetër që mund të ketë ndikuar në mungesën e operatorëve ekonomikë ofertues në këtë tender janë kritere favorizuese/diskriminuese të përcaktuara në pjesën e përshtatshmërisë profesionale dhe kapacitetit teknik dhe profesional. Kjo meqë MI në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë ka përcaktuar një numër të konsiderueshëm të ISO-ve, të cilat sipas shqyrtimit dhe analizimit, dy prej tyre rezultojnë të jenë jovalide.

**ISO IEC 27001 2013 & SA 8000 2014 janë dy ISO të cilat janë rishikuar dhe zëvendësuar me ISO/IEC 27001:2022<sup>22</sup>.**

Përveç ISO-ve jovalide, në kuadër të kriterëve janë përcaktuar një numër i madh i ISO-ve të tjera si: (i) ISO 9001 2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në fushën e ndërtimit, (ii) ISO 14001 2015 - Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit në fushën e ndërtimit – (iii) ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë në fushën e ndërtimit, ndërkaq pjesa e më e madhe e kriterëve për staf profesional i referohet drejtimit elektro. Përkundër që këto certifikata janë të lidhura ngushtë me menaxhimin e proceseve dhe sigurimin e cilësisë dhe sigurisë në ndërtim, të njëjtat nuk janë drejtpërdrejtë të aplikueshme për teknologjinë elektro, e cila ndër të tjerash është një fushë më specifike.

Është e qartë se përcaktimi i kriterëve teknike dhe profesionale bëhet në mënyrë që të sigurohet dhe garantohet kualitet gjatë kontraktimit të OE-së dhe implementimit të kontratës. Mirëpo, në asnjë rrethanë nuk duhet të përdorën kritere që të eliminohet konkurrenca e lirë në mes të operatorëve ekonomik. Rregullat për prokurim publik përcaktojnë qartë se AK-të nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shumë operatoreve ekonomik<sup>23</sup>.

Për renovimin e objektit N.SH. Mekanizmi, respektivisht për demolimet dhe pastrimet në pozicionin 2.0 të paramasës, OE fitues ka paraqitur çmime të ndryshme për punën e njëjtë e cila do të kryhet.

22 ISO/IEC 27001:2022, Information security, cybersecurity and privacy protection — Information security management systems — Requirements, <https://www.iso.org/standard/27001>

23 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 7.

**TABELA 6.** Oferta e OE fitues për pozicionin 2.0 në paramasë

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Njësia	Çmimi
1.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i rrjetit ekzistues të gypave të ngrohjes qendrore, përfshirë sistemin e ngrohjes qendrore me pajisjet përcjellëse	m <sup>2</sup>	1,333.00	0.50	665.50
2.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimit, përfshirë konservimet preventive të linjave furnizuese dhe ato larguese.	m <sup>2</sup>	1,333.00	1,20	1,559.60
3.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i shtresës finale të dyshemesë nga shtresa e tepisionit, përfshirë nënshtresat deri te pllaka rrafshuese e meskatit.	m <sup>2</sup>	882.00	8.00	7,056.00
4.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i mureve jo konstruktive të brendshme apo pjesëve të tyre nga materiali solid apo i lehtë	m <sup>2</sup>	247.00	15.00	3,705.00
5.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i dritareve – paneleve ekzistuese nga xhami dhe profilet solide	m <sup>2</sup>	107.00	20.00	2,140.00
6.	Demontimi i kontrolluar dhe largimi i mureve ekzistuese të punuara me material solid	m <sup>3</sup>	109.00	35.00	3,815.00

Siç shihet edhe në tabelën më lartë, OE fitues në ofertë ka përcaktuar çmime të ndryshme për punën e njëjtë në renovimin e objektit nga 0.50 cent/m<sup>2</sup> deri në 35 euro/m<sup>2</sup>. Përcaktimi i këtyre çmimeve krijon pasiguri dhe mund të kuptohet si problem me transparencë dhe planifikimit të paqëndrueshëm. Çmimi shumë i ulët mund të nënkuptojë përdorimin e materialeve të dobëta, ndërsa çmimi shumë i lartë mund të sjellë keqpërdorim të fondeve duke ndikuar në qëndrueshmërinë e projektit dhe zbatimit të tij.

# Ministria e Punëve të Brendshme

## Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare<sup>24</sup>

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me 28 shkurt 2024 inicioi tenderin për vendosjen e shtatë (7) ashensorëve të rinj në disa institucione publike si Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), dhe Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK). Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 259,240.00 euro.

Në këtë aktivitet të prokurimit ofertuan dy operatorë ekonomikë, teksa MPB rekomandoi për kontratë ofertuesin “Ejona Sh.P.K”, që ofertoj me 179,744.44 euro

■ TABELA 7. Operatorët ekonomikë që morën pjesë në këtë tender

Nr.	Emri i operatorëve ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1.	Uplift L.L.C	248,805.00 euro
2.	Ejona Sh.P.K.	179,744.44 euro

Pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, MPB publikoi edhe njoftimin për dhënie të kontratës. Me datën 05 qershor 2024, u ngarkua draft kontrata në sistemin elektronik, por me datën 17 korrik 2024, MPB publikoi njoftimin për anulim të aktivitetit. Në arsyetimin për anulim, arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik u dha “një dispozitë e LPP kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, ndërkohë si informacion shtesë u cek se nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të LPP.

Sipas MPB-së, kjo kontratë nuk është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), dhe Ministri, për shkak se gjatë analizës, janë hasur parregullsi dhe lëshime nga njësia e kërkesës, divizioni i prokurimit dhe nga operatori i rekomanduar për kontratë. Në bazë të kësaj analize, sipas MPB-së, është konstatuar se:

- Nuk është kërkuar e as prezantuar autorizimi nga prodhuesi;
- Si dëshmi e garancisë (e kërkuar 12 muaj në Dosje të Tenderit) është prezantuar deklarata e operatorit ekonomik;
- Nuk është kërkuar e as prezantuar së paku katalogu i ashensorëve.

<sup>24</sup> Numri i prokurimit: 214-24-1625-1-1-1.

MPB me këtë vendim dhe arsyetim ka shkelur LPP-në dhe Rregulloren e Prokurimit Publik, e cila në mënyrë decisive parasheh që autoriteti kontraktues obligohet që pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, të përgatisë draftin e kontratës dhe të nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike<sup>25</sup>.

Legjislati në fuqi parasheh mundësinë e anulimit të procedurës së prokurimit në rastet kur një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë në procedurën e prokurimit e cila nuk mund të parandalohet përmes amandamentimit të kushteve ligjore të prokurimit si dhe ofertat përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin<sup>26</sup>.

Në bazë të analizimit të Dosjes së Tenderit, MPB nuk specifikoi se në çfarë mënyre duhet të ofrohet dëshmia e garancisë, ndaj deklarata e operatorit ekonomik plotëson këtë kriter. MPB, në Dosjen e Tenderit nuk kërkoi asnjë lloj autorizimi, e as katalogu nga prodhuesi. Andaj, lëshimet dhe mungesa e vëmendjes gjatë hartimit të kriterëve të tenderit nuk përbëjnë arsye ligjore për anulimin e procedurës së tenderimit, kur këto mangësi nuk janë reflektuar në njoftimin e kontratës apo Dosjen e Tenderit. LPP specifikon qartë që autoriteti kontraktues nuk mund të diskualifikojë ose përjashtojë tenderuesit bazuar në kërkesa apo kritere që nuk janë përcaktuar qartë dhe paraprakisht. Në rastin konkret, anulimi i aktivitetit të prokurimit nga MPB për mungesën e katalogëve, autorizimit nga prodhuesi dhe formës së dëshmisë së garancisë është një shkelje e parimeve të transparencës dhe drejtësisë. Arsyet e anulimit të procedurës nga MPB janë kërkesat të cilat nuk ishin të specifikuara në dokumentet e tenderit. Ky veprim jo vetëm që bie ndesh me dispozitat e LPP-së, por ngre pikëpyetje mbi cilësinë e përgatitjes së tenderëve dhe interpretimin e dispozitave ligjore.

## Shërbime për dezinfektim, dezinfektim, deratizim për Ndërtesat Qeveritare - Ri tender<sup>27</sup>

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me datë 4 nëntor 2024, publikoi njoftimin për nënshkrim të kontratës për Shërbime për dezinfektim, dezinfektim, deratizim për Ndërtesat Qeveritare (DDD) me operatorin ekonomikë Doctor Exterminator DDD Sh.P. K, me vlerë të kontratës 313,482.10 euro të zhvilluar sipas procedurës së hapur.

Kjo kontratë i paraprinë aktivitetit të parë (Shërbime për Dezinfektim, Dezinfektim, Deratizim për Ndërtesat Qeveritare) të anuluar<sup>28</sup>, pas shqyrtimit të ankesës nga OShP të parashtruar nga operatori ekonomikë Doctor Exterminator DDD Sh.P.K, ku kriteret e përcaktuara mbi kapacitetin teknik dhe/ose profesional u konfirmuan si diskriminuese dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në mes të operatorëve ekonomikë<sup>29</sup>.

Megjithatë, MPB në ritenderimin e aktivitetit të prokurimit ka përcaktuar po të njëjtat kritere të dhënies së kontratës të cilat bien në kundërshtim me rekomandimin e OShP-së. Njëherazi, ky veprim nga ana e autoritetit kontraktues është në kundërshtim edhe me nenin 105, pika 2.10 dhe 2.11 të LPP-së i cili thekson se autoriteti kontraktues është i detyruar që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar dhe të mënjanoj kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet.

25 Rregullore e Prokurimit Publik. Neni 42, pika 4.

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 62.

27 Numri i prokurimit: 214-23-13757-2-1-1.

28 Aktiviteti me numër 214-23-6093-2-1-1.

29 Vendimi i OShP-së me numër 529/23.

Për kriteret e vendosura tek kapaciteti teknik dhe profesional, operatori ekonomik OE Doctor Exterminator DDD Sh.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë MPB-së si shkallë e parë ankimore për përmirësim të kriterëve të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftim për Kontratë. Ndërkaq, më 15 janar 2024 autoriteti kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim ku ka listuar një mori argumentesh se kriteret e vendosura nuk cenojnë integritetin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të njëjtat nuk kanë të bëjnë me diskriminim dhe favorizim të operatorëve ekonomikë.

MPB, në cilësinë e autoritetit kontraktues përpiloi disa kërkesa të cilat pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim, u apeluan në OShP për të dytën herë radhazi. Konkretisht, tek kapaciteti teknik dhe profesional, AK kërkoi një Agronom ose Veterinar ose Ekolog (sipas MBPZHR)<sup>30</sup> dhe një teknik të veterinarisë të cilat janë kufizuese dhe diskriminuese në këtë tender, meqë sipas MBPZHR, kompanitë të cilat aplikojnë që të pajisen me leje për ofrimin e shërbimeve DDD, duhet që të kenë kualifikime në: Fakultetin e Bujqësisë-drejtimit: Drejtimi i Përgjithshëm; Drejtimi Prodhimtaria Bimore; Drejtimi Mbrojtja e Bimëve dhe Veterinarisë), Fakulteti i Mjekësisë -Drejtimi i Epidemiologjisë; Fakulteti i Biologjisë, Drejtimi i Ekologjisë<sup>31</sup>.

OShP aprovoi si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik OE Doctor Exterminator DDD Sh.P.K, në lidhje me kriteret e përcaktuara tek kapacitetet teknike dhe profesionale, duke konstatuar se kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktues, që operatori ekonomik të ketë një Agronom ose Veterinar ose Ekolog (sipas MBPZHR)<sup>32</sup> dhe një teknik të veterinarisë janë kriterë kufizuese dhe se është përgjegjësi e MBPZHR për të përcaktuar profesionet që duhet të ketë operatori ekonomik për licencim për ofrimin e shërbimeve të DDD-së. Për më tepër, paneli shqyrtues ka konstatuar se përmirësimi i Dosjes së Tenderit do të ofroj mundësi më të madhe për pjesëmarrje të operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit<sup>33</sup>. Legjislacioni në fuqi për prokurim publik, përkatësisht neni 51 paragrafi 3 definon qartë se të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë relevante dhe proporcionale me natyrën e tenderit.

Andaj, duke qenë se kriteret e dhënies së kontratës nuk ishin hartuar në përputhje me natyrën e prokurimit dhe nuk garantonin qasjen më të mirë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, OShP mori vendim që për këtë aktivitet të prokurimit të bëhet përmirësimi i Dosjes së Tenderit bazuar në dy raportet e ekspertit shqyrtues. MPB publikoi formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datën 17 prill 2024 apo 14 ditë pas vendimit të OShP-së.

Pas përmirësimit të kriterëve tek kapaciteti teknik dhe profesional, në këtë aktivitet të prokurimit ofertuan tre operatorë ekonomik.

---

30 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kërkesat edhe kualifikimet e stafit për ti licencuar kompanitë për dezinfektim, dezinfektim, deratizim.

31 Përgjigje e ofruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 29.11.2024.

32 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kërkesat edhe kualifikimet e stafit për ti licencuar kompanitë për dezinfektim, dezinfektim, deratizim.

33 Vendimi i OShP-së me numër 66/24.

**TABELA 8.** Operatorët ekonomik ofertues në këtë tender

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Doctor Exterminator DDD Sh.P.K	313,482.10 €
2.	GEO Besim A. Zenjullahu B.I & Tresor Home L.L.C	225,416.10 €
3.	GEO NRG Sh.P.K & Dezinfekta NRG Sh.P.K	198,391.70 €

Hapja e ofertave për këtë tenderë është bërë me 07 maj 2024, ndërkaq njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues me anë të të cilit MPB rekomandon për kontratë Doctor Exterminator DDD Sh.P.K është publikuar me datë 21 qershor 2024 apo 45 ditë pas afatit të paraparë ligjor. Kjo meqë rregullat për prokurim publik kërkojnë që procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, duhet të kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave, vetëm në raste të natyrave komplekse mund të zgjatet edhe për 20 ditë<sup>34</sup>.

Kundër njoftimit për vendim të datës 21 qershor 2024, GEO Besim A. Zenjullahu B.I & Tresor Home L.L.C i pakënaqur me vendimin, ka parashtruar ankesë në OShP me datë 8 qershor 2024, ndërsa paneli shqyrtues ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e GEO-së duke lënë në fuqi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues<sup>35</sup>.

Njoftimi për nënshkrimin e kontratës, i publikuar më 4 nëntor 2024, vjen 10 muaj pas fillimit të procedurës së prokurimit. Kjo vonesë është në kundërshtim LPP, i cili obligon autoritetet kontraktuese të sigurojnë një mënyrë sa më efikase, transparente dhe të drejtë për shfrytëzimin e fondeve dhe burimeve publike. Nëse procedura do të ishte zhvilluar bazuar në rekomandimin e OShP-së, do të mund të ishte kursyer kohë duke kontribuar në ekonomizimin e procesit dhe përdorimin më racional të fondeve publike. Kjo do të kishte siguruar një realizim më të shpejtë dhe më efikas të kontratës, duke shmangur vonesat të cilat kanë ardhur si pasojë e kriterëve të vendosura në Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontratë.

<sup>34</sup> Rregullore për Prokurim Publik, neni 40, pika 3.

<sup>35</sup> Vendimi i OShP-së me numër 605/24.

# Komuna e Gjakovës

## Ndërtimi i Rrugës X<sup>36</sup>

Komuna e Gjakovës më 30.01.2023 ka publikuar njoftimin paraprak për ndërtimin e rrugës X, me qëllim realizimin e projektit kryesor të unazës veriore (rruga X) dhe rrethrotullimi në zgjerimin e rrrugës Piskotë-Skivjan, Gjakovë. Kontrata kishte vlerë të parashikuar prej 4,357,000.00 euro, ndërsa, më 17.04.2023 u publikua edhe njoftimi për kontratë.

Për këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Gjakovës përdori kriterin e dhënies çmimit ekonomikisht më të favorshëm, ndërsa në Dosje të Tenderit dhe njoftimin për kontratë ka përcaktuar një numër të madh të kriterëve të cilat janë të larta dhe joproportionale me natyrën e këtij tenderi.

Lidhur me kriteret e përcaktuara mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, operatori ekonomik PE-VLA-KU SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues me qëllim që të sigurohet integriteti i prokurimit duke ju ofruar mundësi të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë për ofertim. Komuna e Gjakovës ka aprovuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe përmes formularit B54 - Formulari standard për korrigjimin e gabimeve të datës 9 maj 2024, ka përmirësuar kriteret e vendosura. Megjithatë, një veprim i tillë nga Komuna e Gjakovës është në kundërshtim me Rregulloren për prokurim publik, respektivisht nenin 27.7 i cili definon qartë se kriteret e dhënies së kontratës në rastet kur përdoret çmimi ekonomikisht më i favorshëm nuk mund të ndryshohen përmes formularit, mirëpo përmirësimi i vetëm mund të bëhet përmes anulimit të procedurës së prokurimit dhe ritenderimit<sup>37</sup>.

Ky tender është përcjellur me një sërë parregullësi ligjore dhe procedurale të cilat kanë penguar finalizimin e tij me kontratë. Shkak kryesor i kësaj vonese janë vendimet e kundërligjshme të autoritetit kontraktues ndaj të cilave janë paraqitur shtatë kërkesa për rishqyrtim, të refuzuara si të pabazuara nga autoriteti kontraktues dhe gjashtë ankesa në OShP, të cilat kanë shkaktuar vonesa dhe pamundësi në menaxhimin efikas të procedurës.

Procesverbali i hapjes së tenderëve është publikuar më 22.05.2023, ndërsa në këtë tender kanë ofertuar gjashtë operatorë ekonomikë.

<sup>36</sup> Numri i prokurimit: 632-23-397-5-1-1.

<sup>37</sup> Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 27.7, [https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001\\_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf](https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf).

**TABELA 9.** Operatorët ekonomikë ofertuese në këtë tender dhe vlera e ofertave

Nr.	Operatori ekonomik ofertues	Vlera totale e ofertave
1.	Shkemi Sh.P.K	4,514,770.28 €
2.	GEO Asphalt Group Sh.P.K & Gurëbardhi Sh.P.K & Benita Copmany & Dreoni Sh.P.K	4,333,333.33 €
3.	GOE PE-VLA-KU Sh.P.K & Joos & Krasniqi bazë Sh.P.K & Roza Romani B.I	4,270,543.21 €
4.	Arfa Group Sh.P.K	4,442,527.61 €
5.	Lika Trade Sh.P.K	4,171,825.00 €
6.	GEO N.SH.T Viktory Com & Companya Eskavatori Sh.P.K & Marisa Sh.P.K	4,070,546.33 €

Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me anë të të cilit Komuna e Gjakovës rekomandoi për kontratë GOE “PE-LA-KU SH.P.K & JOOS & KRASNIQI BAZE SH.P.K & Roza Romani B.I, u publikua me datën 24 korrik 2023, apo 66 ditë pas hapjes së ofertave. Autoritetet kontraktuese obligohen që brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave, të publikojnë njoftimin mbi vendimin dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të zgjatet edhe për 20 ditë<sup>38</sup>.

Pas analizimit të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, i njëjti nuk përmbush kriteret e përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe njoftim për kontratë. Sipas rregullave të përcaktuara ligjore kur aplikohet kriteri për dhënie të kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, dhënia e tillë do të jetë në bazë të kriterëve dhe peshën e kriterëve që janë specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë<sup>39</sup>. Andaj, komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave gjatë vlerësimit të ofertave do të duhej të trajtoj të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë duke vlerësuar ofertat e tyre vetëm konform kriterëve të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Kriteri çmimi ekonomikisht më i favorshëm bazohet në raportin çmim - cilësi dhe kjo nuk nënkupton që operatorit ekonomik i cili ka ofertuar me çmimin më të lirë të shpallet i papërgjegjshëm në rastet kur oferta e tij është më e lirë, madje as LPP nuk përjashton një mundësi të tillë. Në këtë kuptim, kundër njoftimit të datës 24 korrik 2023, GEO Asphalt Group Sh.P.K & Gurëbardhi Sh.P.K & Benita Copmany & Dreoni Sh.P.K dhe GEO N.SH.T Viktory Com & Companya Eskavatori Sh.P.K & Marisa Sh.P.K, të pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues kanë parash-truar ankesë në OShP. Ky i fundit trajtoi këtë rast si të unifikuar dhe vendosi në favor të operatorëve ekonomikë duke rekomanduar rivlerësim të ofertave pasi autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së<sup>40</sup>.

38 Rregullore nr. 001/22 për Prokurim Publik, neni 40.3.

39 Rregullore nr. 001/22 për Prokurim Publik, neni 40.14.

40 Vendimet e OshP-së nr. 560/23 dhe nr. 572/23.



Në rivlerësim të ofertave, Komuna e Gjakovës kishte vendosur që të anuloi aktivitetin e prokurimit për shkak të ngjarjeve apo arsyeve objektive të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit, duke përmendur faktin dhe shkëmbimin e imellave me Ministrinë e Infrastrukturës (MI) sipas të cilëve kjo e fundit po harton një projekt ideor për rrugën Skivjan - Lugbunar, e cila përfshinë segmentin e rrugës X. Megjithatë, rregullat për prokurim publik përcaktojnë në mënyrë decizive se në cilat raste mund të bëhet anulimi i procedurës së prokurimit<sup>41</sup>, andaj ky justifikim i Komunës së Gjakovës është në kundërshtim me LPP-në. Ky tender u apelua përsëri në OShP, ndërsa OShP aprovoi si të bazuar ankesën duke rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim sepse arsyetimi i anulimit nuk është i mbështetur në dokumente faktike, ligj dhe rregullore<sup>42</sup>.

Edhe në rivlerësimin e dytë, vendimi i Komunës së Gjakovës për anulim të procedurës mbetet i pandryshuar, megjithatë ndryshojnë arsyet e anulimit të procedurës. Sipas autoritetit kontraktues asnjë nga operatorët ekonomikë nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit dhe ofertat kanë tejkaluar vlerën e parashikuar. Nga ofertat e paraqitura në tabelën 9 vërehet se katër nga gjashtë operatorët ekonomikë nuk tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës.

Edhe ky vendim u apelua në OShP i cili u aprovua si i bazuar përmes së cilit paneli shqyrtues ka kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues që të respektoj vendimet e OShP-së për vlerësim të drejtë të ofertave dhe në mënyrë të barabartë ashtu siç kërkojnë dispozitat ligjore, në të kundërtën, paneli shqyrtues do të kërkojë nga KRPP anulimin e licencës për zyrtarin përgjegjës të prokurimit sipas legjislacionit në fuqi<sup>43</sup>.

Pavarësisht se në të gjitha ankesat e parashtruara, OShP ka kërkuar që të kthejë lëndën në rivlerësim me qëllim të vlerësimit të drejtë të ofertave duke marrë parasysh operatorët ekonomikë të përgjegjshëm të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe njoftim për kontratë, AK nuk ka zbatuar vendimet e OShP-së duke vazhduar në anulim të procedurës. Mosrespektimi i vendimeve të OShP-së, të cilat janë obligative për autoritetin kontraktues përbën shkelje të dispozitave ligjore, respektivisht shkelje të nenit nenin 105, pika 2.10 dhe 2.11 të LPP-së<sup>44</sup>.

Përkundër vendimeve detyruese të OShP-së, Komuna e Gjakovës me datë 4 tetor 2024 publikoi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me anë të të cilit anulon edhe njëherë tjetër procedurën e prokurimit në mungesë të operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm, ndaj të cilit paraqitet përsëri ankesë në OShP, ndërsa kjo e fundit ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar lidhur me këtë.

Lidhur me këtë tender, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të autoritetit kontraktues. Sipas KRPP-së, përkundër të gjitha shkeljeve procedurale dhe ligjore që ndërlidhen me udhëheqje të procedurës dhe moszbatim të vendimeve të OShP-së, të njëjtit nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për anulim të licencës së prokurimit publik për zyrtarin përgjegjës për prokurim publik nga OShP<sup>45</sup>.

Komuna e Gjakovës, si autoritet kontraktues gjatë udhëheqjes së procedurës ka shfaqur mungesë të transparencës dhe vlerësimit të drejtë të ofertave, duke mos respektuar kriteret e dhënies për çmimin ekonomikisht më të favorshëm. Ky mosrespektim i procedurave ligjore dhe moszbatimi i vendimeve të OShP – së, ka sjellë vonesa të konsiderueshme në procesin e këtij prokurimi, duke rritur dyshimet për diskriminim dhe favorizim të disa operatorëve ekonomikë. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në efikasitetin dhe ekonomikitetin e procesit të prokurimit pasi që nga inicimi i procedurës deri në publikimin e njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 4 tetor, kanë kaluar 536 ditë dhe ende nuk ka një epilog final për këtë aktivitet të prokurimit.

41 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 62.

42 Vendimi i OShP-së nr. 0100/24.

43 Vendimi i OShP - së nr. 0534/24.

44 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 105.

45 Përgjigje e ofruar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik me datë 12.12.2024.

# Komuna e Gjilanit

## Furnizim me uniforma për nxënës të klasave X (dhjeta) të shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit<sup>46</sup>

Komuna e Gjilanit në gusht të vitit 2024 hapi tenderin për furnizim me uniforma për nxënës të klasave të dhjeta (X) të shkollave të mesme në këtë komunë, tender në vlerë të parashikuar të kontratës 54,000.00 euro.

Në këtë tender ofertuan dy (2) operatorë ekonomikë. Komuna e Gjilanit, me datë 10.10.2024, publikoi njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Puntex Sh.P.K", që kishte ofertuar me 52,416.00 euro, ndërkaj komisioni i vlerësimit eliminoi operatorin ekonomik më të lirë ofertues me konstatimin se mostrat e ofruar nga ai nuk ishin të përshtatshme dhe kualitative.

**TABELA 10.** Emrat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Adresa	Vlera totale e ofertës
1.	Naim Shuki B.I	Wesly Clark Pn. Prizren	49,980.00 euro
2.	Puntex Sh.P.K	Komuna e Parisit, 52, Prizren	52,416.00 euro

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, ka konstatuar se mostrat e ofruara nga OE Naim Shuki B., nuk janë të përshtatshme dhe kualitative. Sipas komisionit të vlerësimit operatori ekonomik Puntex Sh.P.K i plotëson kriteret sipas specifikimeve të përcaktuara në aneksin 1 dhe mostrat e ofruara janë më të përshtatshme dhe kualitative.

Në bazë të analizimit të ankesit 1 të Dosjes së Tenderit, Komuna e Gjilanit nuk kishte paraqitur asnjë specifikim teknik i cili do të mund të përshkruante cilësinë, qëndrueshmërinë apo standardin e kërkuar, si: materialin kryesor që duhet ta kenë uniformat (p.sh. pambuk, polister), përqindjen e përbërjes (p.sh 60% pambuk, 40% poliester), trashësinë e materialit, rezistencën ndaj larjeve, ngjyra specifike sipas kodit Pantone ose RAL, të cilat janë sisteme standardizimi që përdoren për të identifikuar dhe përcaktuar ngjyrat në mënyrë të saktë dhe universale.

<sup>46</sup> Numri i prokurimit: 651-24-6314-1-2-1.

Në mungesë të specifikimeve teknike të qarta dhe të detajuara, komisioni i vlerësimit nuk ka bërë dhe nuk ka mundur të bëjë vlerësim objektiv midis mostrave të ofruara nga operatorët ekonomikë, për shkak se nuk kanë ekzistuar kritere të përcaktuara për cilësinë, materialin, ngjyrën dhe standarde tjera, ndaj konstatimi që një operator ekonomik ka ofruar mostra “më të përshtatshme dhe kualitative”, është interpretim personal i anëtarëve të komisionit pa arsyetim objektiv se cili element i mostrave të dorëzuara nuk është plotësuar nga operatori ekonomik i eliminuar.

Dokumentet e tenderëve në përgjithësi rekomandohen që të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertave. Rregullorja e Prokurimit Publik<sup>47</sup>, shprehimisht kërkon që tenderuesve duhet tu kërkohet që të konfirmojnë që produktet e ofruara të plotësojnë specifikimet e kërkuara, gjë e cila mund të vërtetohet duke bashkangjitur certifikatat e testimit nga laboratorët. Rregullorja po ashtu parasheh, që para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet ti largohen të gjitha shenjat që mund të identifikojnë operatorin ekonomik dhe të njëjtat të shënohen me kod.

Mungesa e kritereve të mirë përcaktuara jo vetëm që cenon integritetin dhe transparencën e procesit, por edhe rrezikon të çojë në vendime subjektive dhe të pajustificueshme, si në këtë rast, ku u eliminua një operator ekonomik, ndërkohë u rekomandua për kontratë një ofertues tjetër i cili ishte për 2,436 euro më i lartë.

---

<sup>47</sup> Rregullorja për Prokurim Publik 001-2022, Neni 37.6

# Komuna e Pejës

## Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës<sup>48</sup>

Në maj të vitit 2024, Komuna e Pejës, hapi tenderin për trajtimin e qenëve endacak dhe menaxhimin e strehimores, me anë të të cilit synonte të siguronte një operator ekonomik i cili do të bënte grumbullimin e qenve endacak, trajtimin, vaksinimin dhe kastrim/sterilizimin e mbi 2,000 qenëve në territorin e kësaj komune.

Njoftimi për kontratë u publikua me datën 20 maj, ndërkohë afati i fundit për dorëzimin e ofertave u caktua data 10 qershor, apo 21 ditë, që paraqet shkurtim të afatit 40 ditorë për dorëzimin e ofertave të kontratave të vlerës së madhe<sup>49</sup>. Komuna e Pejës dha arsyetimin se ky afat ishte përshpejtuar për shkak se ky tender kishte dështuar herën e parë, ndaj kërkohej një zgjidhje sa më e shpejtë për shkak të rëndësisë së veçantë dhe problematikës së qenëve endacak në këtë komunë.

Komuna e Pejës me datë 19 qershor shpalli fitues grupin e operatorëve ekonomikë “Kuqi Farms Sh.P.K., dhe Ambulanca Veterinare”, që kishin ofertuar me çmimin prej 241,320.00 euro, duke eliminuar grupin e operatorëve ekonomikë “Veterina Pejë (Turhan Nila B.I) & Haki Bytyçi B.I. Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 270,000.00 euro.

**TABELA 11.** Operatorët ekonomikë ofertues në këtë tender

Nr.	Emri i operatorëve ekonomikë	Çmimi total i ofertës
1.	GEO Kuqi Farms Sh.P.K., Ambulanca Veterinare “Drenas”	241,320.00 euro
2.	GEO N.T.Sh Veterina; Haki Bytyçi B.I	264,000.00 euro

Komuna e Pejës, bëri eliminimin e grupit të operatorëve ekonomikë “Veterina Pejë & Haki Bytyçi B.I”, duke u bazuar në një kërkesë të cilin e kishte dërguar në OShP, me datë 12 prill 2024, për diskualifikimin e këtij operatori ekonomik, por që në kohën e eliminimit nuk ishte marrë asnjë vendim nga OShP.

Eliminimi i një operatori ekonomik bazuar vetëm në faktin se është iniciuar një kërkesë për diskualifikim (futje në Listë të Zezë), pa pasur një vendim përfundimtar nga OShP, përbën shkelje të parimeve themelore të LPP. Ky ligj, dhe konkretisht neni 7 i tij, përcakton obligimin e autoriteteve kontraktuese për të trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe duke siguruar një konkurrencë të drejtë dhe të hapur<sup>50</sup>. Në mungesë të një vendimi të formës së prerë nga OShP, thjeshtë iniciimi i një kërkesë nuk është bazë ligjore për të

<sup>48</sup> Numri i prokurimit: 635-24-4874-2-1-1.

<sup>49</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L- 042 për Prokurimin Publik, neni 44, pika 2.1

<sup>50</sup> Ligji për Prokurim Publik, neni 7, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

eliminuar një operator ekonomik nga procesi i tenderimit. Ky veprim jo vetëm që bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, por gjithashtu cenon konkurrencën duke kufizuar pjesëmarrjen e një operatori të cilit ligjërisht nuk i është mohuar e drejta për të konkurruar.

Komuna e Pejës veproi njëjtë edhe me rastin kur nuk bëri vlerësimin e ankesës së operatorit ekonomik të eliminuar, duke iu referuar vendimit të datës 12.04.2024, i cili në fakt nuk është vendim por është kërkesë që komuna i dërgojë OShP-së, për diskualifikimin e këtij operatori ekonomik. Vendimi i Komunës së Pejës për të hedhur poshtë ankesën e operatorit ekonomik “Veterina Pejë & Haki Bytyçi B.I.” duke u bazuar vetëm në një kërkesë për diskualifikim, pa pasur një vendim të formës së prerë nga OShP, përbën një shkelje të qartë të së drejtës ligjore për ankesë dhe trajtim të barabartë. Rregullorja për Prokurimin Publik<sup>51</sup> përcakton qartë që refuzimi ose miratimi i një kërkesë për rishqyrtim nga autoriteti kontraktues duhet të bazohet në një vendim të argumentuar dhe të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik. Mungesa e një vendimi të tillë jo vetëm që cenon transparencën, por edhe mohon të drejtën e operatorit ekonomik për t'u ankuar në mënyrë efektive në shkallën e parë.

Në Dosje të Tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Komuna e Pejës kërkoi që operatorët ekonomikë të kishin listë të mjeteve të punës, pikap, kafaz transportues, qafore, çantë ushqimi dhe mjete kimike që mund të përdoren për kafshë agresive. Këto duhet të dëshmoreshin me librezë të regjistrimit si dhe dokumente tjera të cilat dëshmojnë pronësinë (fatura, DUD doganor). Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ofroi dëshmi sipas kërkesave të autoritetit kontraktues të parapara në këtë pikë.

Një tjetër kërkesë e Dosjes së Tenderit kishte të bënte me objektin e strehimores së qenëve dhe ambulanten e specializuar për ofrimin e shërbimeve brenda territorit të komunës minimum 15 kilometra. Kjo kërkohet të dëshmohej me fotografi ose fletë poseduese dhe në rast të qirasë, kërkohet të ofrohej marrëveshja e noterizuar në emër të këtij projekti.

Duke u bazuar në fotografitë e dorëzuara nga operatori i rekomanduar për kontratë, nuk dëshmohej se objekti i strehimores gjendej në lokacionin e kërkuar dhe se i njëjti nuk konfirmohej se i plotësonte kushtet teknike të parapara me Udhëzimin Administrativ për Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese<sup>52</sup>.

Në lidhje me këtë tender, OShP me 6 shtator, aprovoi kërkesën e operatorit ekonomik N.T.Sh Veterina<sup>53</sup>, duke anuluar vendimin e Komunës së Pejës me konstatimin se ky autoritet kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë prokurimin publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke kthyer lëndën në rivlerësim.

Komuna e Pejës në rivlerësimin e bërë me 25 shtator 2024, përsëri rekomandoi për kontratë grupin e operatorëve ekonomikë “Kuqi Farms Sh.P.K., Ambulanca Veterinere Drenas”, duke pranuar për dëshmi një skicë të matjes, me anë të të cilës gjeodeti konstatoi se në atë parcel ishte ndërtuar një hapësirë e destinuar për qenët endacak. Ndonëse lejohet që autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender, këto dokumente në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. Pavarësisht kësaj, Komuna e Pejës ka pranuar këtë sqarim të operatorit ekonomik, i cili është përgatitur pas datës së publikimit për kontratë, që nuk vërteton në mënyrë objektive se kjo gjendje ka ekzistuar para datës së publikimit për kontratë. Për më tepër, raporti i gjeodetit vetëm se konfirmon ekzistimin e një strukture të dedikuar për qenë endacakë, por ky raport gjeodezik nuk përmban asnjë shpjegim se struktura e prezantuar në fotografi plotëson kërkesat teknike

51 Rregullorja e Prokurimit Publik. Neni 63.

52 Udhëzimi Administrativ (MPBZHR) – NR.02/2023 për Kushtet dhe Kërkesat Teknike që duhet plotësuar nga Strehimorët e Kafshëve Shoqëruese. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=75171>

53 Vendimi nr. 2024/0606. Gjendet në: <https://shorturl.at/1lwh3>

të Udhëzimit Administrativ, si distanca nga vendbanimi më i afërt, hapësira e rrethuar, tabela më të dhënat e strehimores etj.

Përkundër faktit që Komuna e Pejës e ka konsideruar urgjent trajtimin e qenëve endacak dhe menaxhimin e strehimores, procesi i tenderimit ende nuk ka rezultuar në lidhjen e një kontrate të vlefshme, kryesisht për shkak të gabimeve në vlerësim dhe interpretimeve të pasakta të LPP.

## Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimi nga fshati Vitomirice deri te fshati Novoselle (Rruga R106)<sup>54</sup>

Komuna e Pejës, me datën 8 maj 2024, hapi tenderin për shtatë (7) projekte të ndara në lote, në vlerë të përgjithshme prej 800,093.00 euro, projekte këto të cilat ishin në bashkëfinancim me DEMOS<sup>55</sup> në kuadër të Grantit të Performancës.

Loti 1, i këtij tenderi, i cili ishte vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimit nga fshati Vitomiricë deri në fshatin Novosellë (Rruga R106), kishte vlerë të parashikuar të kontratës 103,418.00, rezultoi i pasuksesshëm, pasi asnjë nga gjashtë (6) ofertuesit nuk arriti të përmbushë kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Kriteret e vendosura në Dosje të Tenderit ishin shumë të larta dhe të papërshtatshme me natyrën e kontratës, duke përfshirë kërkesa për staf profesional dhe përvojë pune që tejkalonin nevojat reale të projektit.

Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në Dosje të Tenderit, kërkohej që operatorët ekonomikë të angazhonin dy inxhinierë të diplomuar me përvojë të konsiderueshme dhe kualifikime shtesë:

- **Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose me master në drejtimin energjetik** me pesë (5) vite përvojë pas diplomimit, që duhej të ishte gjithashtu i certifikuar si auditor i energjisë nga një institucion i akredituar dhe të shërbente si menaxher projekti.
- **Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose me master konstruktiv**, gjithashtu me pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit, i certifikuar për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe ndërhyrjet emergjente.

Për të dëshmuar këto kriteret, kërkohej numër i dokumenteve si: diploma, certifikata, kontrata dhe vendime për menaxherët dhe udhëheqësit e projektit, të gjitha të noterizuara në prani të palëve. Kjo paraqet një barrë administrative të tepruar për ofertuesit dhe kufizon procesin e tenderimit, sidomos për operatorët e vegjël ose të themeluar rishtazi.

<sup>54</sup> Numri i prokurimit: 635-24-10760-5-2-1.

<sup>55</sup> DEMOS - Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahje Komunave i cili financion Grantin e Përfundimit të Komunave bazuar në Ligjin nr. 08/I-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.

Pavarësisht faktit se vendosja e kriterëve është në diskrecionin e autoritetit kontraktues, natyra e kontratës dhe punët që duheshin kryer nuk përmbanin ndërlikime teknike të tilla që të justifikonin këto kërkesa të larta. Punët e përcaktuara përfshinin:

- Vendosjen e shenjave të përkohshme vertikale dhe sigurimin e trafikut gjatë punimeve.
- Furnizimin, transportimin dhe shtruarjen e materialit mbushës zhavorik.
- Ngjyrosjen e shenjave për sinjalizimin e rrugës për këmbësorë dhe biçikleta.
- Montimin e shtyllave për ndriçim.

Këto janë punë rutinë për projekte infrastrukturore dhe nuk kërkojnë një nivel të lartë kompleksiteti teknik. Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve të larta për kualifikim është e papërshtatshme, joproporcionale dhe kufizon konkurrencën. Në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik<sup>56</sup>, specifikimet teknike dhe kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Pas anulimit, Komuna e Pejës vazhdoi me ritenderim, duke publikuar njoftimin për kontratë me datën 14 tetor 2024, por shkurtoi afatin për dorëzimin e ofertave në nëntë (9) ditë, me arsyetimin se njëzia kërkuese ka paraqitur këtë kërkesë dhe se ky projekt ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës dhe se mjetet për këtë projekt ishin ndarë nga DEMOS në vlerë 80,000 euro për vitin 2024.

Shkurtimi i afatit për dorëzimin e ofertave në këtë procedurë në vetëm nëntë (9) ditë, është në kundërshtim me LPP, i cili parasheh një afat minimal prej 20 ditësh për kontratat publike që nuk janë të vlerës së madhe<sup>57</sup>. Edhe në rastet kur aplikohen rregulla të posaçme për shkurtimin e afateve kohore, ligji kërkon që kjo të bëhet vetëm në rrethana urgjente që nuk mund t'i atribuohen veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues dhe jo më pak se 10 ditë<sup>58</sup>.

Arsyetimi i dhënë nga komuna për rëndësinë e projektit dhe përfitimin nga fondet e DEMOS-it, nuk përmbush kushtet ligjore për një afat të posaçëm pasi nuk ekzistojnë rrethana urgjente. Shkurtimi i afatit jo vetëm që shkel ligjin, por gjithashtu ndikon në uljen e konkurrencës, duke kufizuar mundësinë e operatorëve ekonomikë për të përgatitur dhe dorëzuar oferta cilësore në kohën e kërkuar. Në ritenderim, ofertuan vetëm tre (3) operatorë ekonomikë, ku vetëm njëri u cilësua se kishte plotësuar kushtet. Komuna e Pejës me datën 05 nëntor 2024 rekomandoi për kontratë grupin e operatorëve ekonomikë Valdrini sh.p.k; IBRAHIM KURRUMELI B.I.; NISI ING SH.P.K, të cilët kishin dorëzuar ofertë në vlerë 103,333.30 euro, apo 99.9% e vlerës së parashikuar të kontratës.

56 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 28.

57 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 44.

58 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 45.

# Të gjeturat

## MINT

**1** MINT ka përfshirë në procesin e vlerësimit hartuesin e specifikimeve teknike: Rregullat për prokurim publik ndalojnë që hartuesit e specifikimeve teknike jetë pjesë e procesit të vlerësimit të ofertave, me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit dhe vlerësim të drejtë të ofertave. Me përfshirjen e hartuesit të specifikimeve në këtë proces, MINT ka vështirësuar garantimin e një procesi të paanshëm dhe të drejtë, çka mund të rezultojë në favorizim dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë.

**2** MINT ka kontraktuar operatorin ekonomik me çmime jo-normalisht të ulëta: MINT kishte parashikuar 60,000.00 euro për këtë kontratë, ndërsa operatori ekonomik fitues ka ofertuar vetëm 18,000.00 euro. Kontraktimi i operatorit ekonomik me 70% më vlerë më të ulët sesa vlera e parashikuar e kontratatës pa aplikuar rregullat për tender jo-normalisht çmime të ulëta gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve rrezikon realizim cilësorë të kontratatës.

## MI

**3** MI kundërligjshëm ka anuluar procedurën e prokurimit: Pavarësisht operatorit ekonomik të përgjegjshëm, mungesa e një vlerësimi të drejtë dhe të saktë të ofertave nga autoriteti kontraktues ka rezultuar në anulim të procedurës. Ky veprim shkel parimet e transparencës dhe barazisë së operatorëve ekonomik gjatë procesit të prokurimit.

## MPB

**4** MPB nuk ka respektuar vendimet e OShP-së përkundër obligimit ligjor për zbatim të tyre: MPB gjatë udhëheqjes së procedurës përveç shkurtimit të afateve në mënyrë të kundërligjshme, ka vazhduar të përdorë kritere diskriminuese/favorizuese dhe jo-relevante të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në procesin e prokurimit.



## Komuna e Gjakovës

**5** Komuna e Gjakovës nuk ka zbatuar rregullat për çmimin ekonomikisht më të favorshëm gjatë fazës së udhëheqjes së procedurës së prokurimit, ashtu sikurse edhe gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave. Tutje, Komuna e Gjakovës ka vepruar kundërligjshëm duke rekomanduar kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm. Komuna e Gjakovës pas aneksave të parashtruara në OShP në kundërshtim me dispozitat ligjore ka anuluar katër herë radhazi procedurën e prokurimit.

## Komuna e Gjilanit

**6** Komuna e Gjilanit nuk ka përcaktuar specifikime teknike të detyrueshme: Mospërcaktimi specifikimet teknike të qarta dhe të detyrueshme në Dosjen e Tenderit ka konsistuar në vlerësime subjektive të mostrave të pranuar nga operatorët ekonomik, duke krijuar mundësi për favorizimin e operatorëve të caktuar dhe kontraktim të operatorit ekonomik më të shtrenjtë.

## Komuna e Pejës

**7** Komuna e Pejës ka eliminuar operatorin ekonomik vetëm në bazë të një kërkesë për diskualifikim dërguar OShP-së, pa pasur një vendim të formës së prerë nga ky organ. Përkundër, rëndësisë për kontraktim të operatorit ekonomik, procesi i tenderimit ende nuk ka rezultuar me lidhje të kontratës për shkak të gabimeve në vlerësimin e ofertave dhe interpretimeve të pasakta të LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues.

**8** Komuna e Pejës ka dështuar të kontraktojë operatorin ekonomik për shkak të kërkesave të larta dhe jo-relevante në Dosje të Tenderit: Përcaktimi i kriterëve të larta dhe jo-relevante pason me mungesë të konkurrencës në mes të operatorëve ekonomik ku në rastin konkret kanë ofertuar vetëm tre operatorë ekonomikë.

# Rekomandimet

- 1** Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies: të gjitha autoritetet kontraktuese duhet të rrisin transparencën dhe llogaridhënien në procesin e prokurimit, duke dokumentuar çdo fazë dhe vendim që merret gjatë procedurës, përmes platformës së eprokurimit.
- 2** Përcaktimi i specifikimeve teknike të detyrueshme: autoritetet kontraktuese duhet të sigurohen se hartojnë specifikime teknike të detyrueshme konform nenit 28 të LPP-së. Të njëjtat duhet të jenë të detajuara dhe të përshtatshme për natyrën e tenderit, duke shmangur çdo paqartësi që mund të krijojë mundësi për vlerësime objektive. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një konkurrencë të drejtë dhe të barabartë për operatorët ekonomikë dhe do të parandalojë favorizimin e operatorëve të caktuar, duke mundësuar një proces prokurimi më transparent dhe të besueshëm.
- 3** Përcaktimi i kriterëve të qarta dhe proporcionale me natyrën e tenderit: autoritetet kontraktuese duhet të sigurohen kriteret e përcaktuara në dosjet e tenderëve duhet të jenë të qarta dhe të arsyeshme, të cilat lidhen direkt me natyrën e tenderit. Kjo do të sigurojë që çdo operator ekonomik të ketë mundësi të barabarta për të konkurruar dhe do të minimizojë mundësitë për aplikimin e kërkesave të panevojshme ose diskriminuuese.
- 4** Vlerësimi dhe rivlerësimi i ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë: autoritetet kontraktuese të respektojnë parimin e barazisë gjatë fazës së vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave. Kjo duke siguruar që të gjitha procedurat të jenë të përshtatshme për të identifikuar ofertat e pasakta bazuar në kriteret e përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontratë. Në këtë mënyrë parandalohet edhe diskriminimi i operatorëve ekonomikë. Gjatë këtij procesi, autoritetet kontraktuese duhet të kenë para-sysh edhe eliminimin e dyshimeve për çmime jo-normalisht të ulëta.
- 5** Shqyrtimi i kërkesave për rishqyrtim dhe vendim-marrja lidhur me to: autoritetet kontraktuese duhet të krijojnë një mekanizëm të qartë dhe transparent për shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim në proceset e prokurimit bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik. Shqyrtimi i kërkesave për rishqyrtim brenda kuadrit ligjor dhe vlerësimi i çdo pretendimi të operatorëve ekonomikë në mënyrë të drejtë dhe të detajuar do të minimizonte numrin e ankesave të parashtruara në OShP. Kjo situatë do të kontribuonte në përshejtimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke shmangur vonesat e panevojshme dhe ndër të tjerash duke rritur efikasitetin e përgjithshëm të procedurave të prokurimit.
- 6** Anulimi i procedurave të prokurimit: autoritetet kontraktuese duhet të sigurohen se anulimi i procedurave të prokurimit duhet të ndodhë vetëm në raste të veçanta dhe të justifikuara, në përputhje me ligjin dhe rregulloren në fuqi.
- 7** **Zbatimi i vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit:** autoritetet kontraktuese të zbatojnë në tërësi sipas legjislacionit në fuqi vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit. Autoritetet kontraktuese obligohen që të sigurojnë që çdo vendim i OShP-së të zbatohet pa vonesa dhe në mënyrë të paanshme, për të garantuar integritetin e procesit të prokurimit. Moszbatimi i vendimeve të OShP-së sjellë vonesa në finalizim të procedurave të prokurimit. Për më tepër, moszbatimi i tyre mund të çojë në kërkesën për anulim të licencës së zyrtarit përgjegjës për prokurimin nga ana e OShP-së.



